



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.14/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ, të paditësit Sh.P.K. “P...” me seli në fsh. Sh..., Komuna Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Gashi Avokat, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur me datë 28.09.2022, në prani të përfaqësuesit të paditësit, Avokat Fitim Gashi me autorizim, dhe në mungesë të përfaqësuesit të të paditurës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZHET Kërkesëpadia e paditësit Sh.P.K. “P...” me seli në fsh. Sh..., Komuna Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Gashi Avokat, si e bazuar
- II. Mbetët në fuqi Vendimi nr. 108/2019 i datës 28.03.2019 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, ka pezulluar përkohësisht shqyrtimin e ankesës nr. 26/2014 datë 27.01.2014, deri në përfundimin e procedurës penale.

Paditësi Sh.P.K. “P...” me seli në fsh. ..., Komuna Gjilan, me padinë e tij datës 26.04.2019 të paraqitur në gjykatë ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata të aprovohet padia si e bazuar, të anulohet vendimi për pezullimin e procedurës 108/2019. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se: Konsideroj që e njëjta duhet të aprovohet, për faktin se vendimi i të paditurës është i nxjerrë në kundërshtim me të gjetura e aktgjyqimit të

Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.381/14 të datës 12.02.2019, ngase në shkresat e lëndës tek e paditura ekziston një ekspertizë financiare e punuar nga ekspert gjyqësor, dhe e akceptuar edhe nga e paditura, e cila si provë konsideroj se është e mjaftueshme për të paditurën që të shërbej në procedurën e rishqyrtimit dhe rivendosjes. Andaj, mbi këtë i propozoj gjykatës që ta anuloj vendimin e kontestuar, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, ashtu që e paditura të obligohet të vendos lidhur me ankesën e subjektit, këtu paditësit. Për çështje procedurale dua që ta bëjë rregullimin e padisë, fillimisht me titullin e padisë, ku nga ankesë e bëjmë në padi, duke i shtuar të njëjtës petitumin ashtu që: Të aprovohet kërkesëpadia e paditësit “P...” sh.p.k me seli në Gjilan si e bazuar, të anulohet vendimi nr.108/2019 i datës 28.03.2019, nga e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje pranë të paditurës, dhe të obligohet e paditura që të shqyrtoj ankesën e këtu paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Në përgjigjen në padi të datës 10.09.2020 e paditura thekson se ka vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A. nr. 381/2014 të datës 12.02.2019, ka analizuar dosjen e paditësit dhe sipas rekomandimeve të dhëna në Aktgjykimin e lartëcekur ka vlerësuar se ankesa e paditësit në procedurë do të pezullohet deri sa të përfundojë procedura penale gjegjësisht deri në pranimin e aktgjykimit nga gjykata – divizioni penal. Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ komfor dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se përfaqësuesja ligjore e të paditurës edhe pse e ka pranuar ftesën për këtë seancë e njëjta nuk ka prezantuar, ndërsa me parashtresën e datës 08.02.2022 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në seancë dhe ka kërkuar që të veproj në pajtim me nenin 38 par. 5 dhe nenin 41 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 10.02.2022, ka administruar provat relevante dhe atë: shkresa e ATK-së nr. ... e dt.13.03.20, kërkesa për informata drejtuar ATK-së e dt.20.05.20, vendimi ... i dt.28.07.20, njoftim rivlerësimet për tatimin mbi korporata për periudhën 2015, 2016 dhe 2017 si dhe për TVSH për periudhën 02/15, 03/15, 04/15, 06/15, 07/15, 08/15, 09/15, 01/16, 02/16, 04/16 deri 10/16, 02/17 deri 04/17, 06/17 deri 11/17, përgjigja në padi e dt.19.08.21.

Gjykata komfor dispozitive ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, në seancën e mbajtur me datë 10.02.2022 vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe konstatoi se kërkesëpapia e paditësit është e pa bazuar për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Departamenti i Ankesave-ATK, e ka pezulluar përkohësisht shqyrtimin e ankesës nr. ..., deri në përfundimin e procedurës penale pasi që Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm është duke zhvilluar procedurën penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan nr. Gjykata konstaton se e paditura në vendimin kontestues i ka zbatuar në përpikëri rekomandimet e gjykatës të dhëna përmes aktgjykimit A.nr.381/14 të datës 12.02.2019.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal me aktgjykimit A.nr.381/14 të datës 12.02.2019, a ka provuar kërkesëpadinë e paditësit “P...”, SHPK – me seli në Gjilan, si të bazuar e ka anuluar vendimin nr. 26/2014 të datës 21.02.2014 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek këtu e paditura ATK-ë, pasi që paraprakisht në seancën e shqyrtimit gjyqësor është njoftuar nga përfaqësuesi i paditësit se pranë Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm është duke u zhvilluar procedurë penale në bazë të Aktakuzës së prokurorisë Themelore në Gjilan nr. PP.II.nr. 728/16 kundër këtu paditësit, dhe se procedura penale kundër këtu paditësit ka filluar pas përfundimit të procedurës administrative në Departamentin e Ankesave pranë këtu të paditurës. Andaj edhe mbi bazën e këtyre e ka udhëzuar të paditurën këtu ATK-në për zbatim të nenit 17, par 1 të Ligjit 02/L-28 për procedurën Administrative në fuqi në atë kohë, dhe se duhet të pezulloj procedurën derisa vendimi penal të bëhet i formës së prerë në procedurë penale.

Gjykata ka gjetur se e paditura në vendimin kontestues 108/2019 të datës 28.03.2019, i ka zbatuar në përpikëri rekomandimet e gjykatës të dhëna përmes aktgjykimit A.nr.381/14 të datës 12.02.2019, si më lartë duke e pezulluar përkohësisht shqyrtimin e ankesës nr. 26/2014 të datës 27.01.2014. Gjykata gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së

aktit të kontestuar iu referua dispozitës nga neni 67, të LKA-së, sipas të cilës dispozitë në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “*Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, apo në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, kurse paditësi paraqet një padi të re, gjykata do ta anulojë aktin e kontestuar dhe, si rregull, vetë do të vendosë për çështjen me aktgjykim, Aktgjykimi i tillë e zëvendëson aktin e organit kompetent*”, dhe nga interpretimi i drejtë i kësaj dispozite kjo gjykatë ka gjetur se këtu e paditura i ka marrë parasysh në tersi pikëpamjet juridike dhe vërejtjet e gjykatës të dhëna sikurse në Aktgjykimin A.nr.381/14 të datës 12.02.2019, e me këtë edhe konstatohet se e paditura i është përmbajtur në tersi karakterit të detyrueshëm të Aktgjykimit.

Nga kjo gjendje faktike gjykata i konsideron të pabazuara pretendimet e paditësit si në padi dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor ngase të njëjtat janë të drejtuara sikurse çështja të ishte vendosur meritorisht në procedurë administrative nga e paditura, derisa në rastin konkret sipas udhëzimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal, të dhëna me Aktgjykimin A. nr. 381/14 të datës 12.02.2019, shqyrtimi i ankesës nga e paditura është pezulluar përkohësisht deri në përfundimin e procedurës penale nr. ..., e konsideruar si çështje paraprake në këtë konflikt administrativ.

Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi kontestues i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64 të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, pasi që sipas këtij neni në konflikt administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata komfor dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Departamenti Fiskal / Dhomat e Shkallës së Parë

KF.nr.14/2022, datë 28.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.